

# Si u bë Kosova "KOSOVO"?

Sami ISLAMI

7 nëntor 2009

## Përmbledhje

Në këtë shkrim kemi sjellë disa të dhëna të argumentuara që çojnë në përfundim se emërtimi **KOSOVO**, që është përdorur në të kaluarën, po edhe sot, sidomos nga ndërkombëtarët, e ka burimin nga gjuhët sllave, më sakët nga gjuha serbe dhe, si i tillë, meqë nuk përkon me natyrën gjuhësore të shqipes, duhet shpërrur sa më parë që të jetë e mundur, sepse ne e kemi emërtimin tonë **KOSOVË**.

Shqiptarët gjithmonë Dardaninë e dikurshme e kanë quajtur dhe e quajnë edhe sot "Kosovë" (në trajtën e pashquar) dhe "Kosova" (në trajtën e shquar). Edhe në gjuhët e tjera do të duhej të merrej ky toponim në formën që e thotë vetë shqiptari, pra "Kosovë-a". Mendoj se për shumë gjuhë evropiane apo edhe botërore emri "Kosovë-a" nuk duhet të jetë problematik për t'u artikuluar. Zakonisht, të huajt, kur i marrin fjalët (emrat etj.) prej një gjuhe tjetër, ata i marrin në trajtën ashtu siç u servohet. Disa gjuhë, duke u nisur nga ligjet fonetike e gramatikore të tyre, fjalët e gjuhëve të tjera ia përshtatin sistemit fonetik dhe gramatikor të gjuhës së vet. Mirë. Por nga erdhi atëherë në gjuhët evropiane p. sh emri "Kosovë-a" i shqiptuar "Kosovo", që ndeshet jo vetëm në gjuhën angleze, por edhe në gjuhët e tjera? Pse po del pra, kjo fjalë, me mbaresën **-o**, e jo me mbaresën **-a** (në të shquarën), siç i takon natyrës së gjuhës shqipe? Përgjigjja është shumë e thjeshtë. Kjo trajtë erdhi e "shqiptuar", jo direkt nga shqipja, por pikërisht nga gjuhët sllave, si: serbe, bullgare apo maqedonase. Këto gjuhë kanë prirjen që emrat që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret **-v** ose **-k** marrin mbaresën **-o**. Kemi emra të truallit shqiptar por edhe të tjerë që i ndeshim të shqiptuar kështu: Malishevo, Kumanovo, Bërçko, Jadransko more (Deti Adriatik), Mavrovo, Gjakovo etj. Sipas këtij kriteri shkon edhe emërtimi "Kosovo".

Gati një shekull Kosova "jetoj" nën ombrellën e Serbisë dhe emri "**Kosovo**" herë si "provincë", e herë si "krahinë e Serbisë". Ky emër, në fakt, përdorej ndoshta vetëm për përdorim "të brendshëm" të saj. Serbia përpiqej me çdo kusht ta mbante të mbyllur Kosovën. Bile, më kujtohet, kur në vitet e 60-ta Serbia e ndryshoi emrin. Pra prej "**Kosovo**" e bëri "**Kosmet**", që ishte një shkurtesë nga "**Kosovo i Metohija**" (Kosova dhe Metohia), për t'i "humbur" gjurmët e Kosovës shqiptare sa më shumë që të ishte e mundur. Nacionalistët serbë këtë emërtim e përdorin edhe sot. Pra nga "Kosova" ata morën rrokjen e parë "**Kos**" dhe nga **Metohija**, po ashtu rrokjen e parë "**Met**". Hajde gjeje tash se ku është ky "Kosmeti" në këtë planet! Politika që ndiqte Serbia në ish- Jugosllavi ishte që t'i ngulfaste "pakicat", e në rend të parë shqiptarët e Kosovës.

Para çlirimit, jashtë Jugosllavisë (lexo: edhe jashtë Serbisë) pakkush e ka ditur se ku është Kosova. Në mënyrë mjaft të bujshme emri i Kosovës doli, dhe i "shpërthei" kufijtë e Serbisë gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe pas saj. Është interesante të theksohet se Kosova tani filloi të njihej kudo në arenën ndërkombëtare, jo me emrin shqip të saj "**Kosovë-a**", por me trajtën sllave (lexo: serbe) "**Kosovo**". Ky "prezantim" i Kosovës nga Serbia "u bë" model i përdorimit pothuaj edhe nga të gjitha organizatat ndërkombëtare, që vepruan dhe veprojnë ende në Kosovë.

Po të kthehemi pak në histori, do të vërejmë qartë se serbët, bullgarët, me një fjalë sllavët, qenë më të organizuar nga pikëpamja institucionale e shtetërore. Së këndejmi ata i planifikonin punët me dekada e shekuj përpara, e cila gjë mund të vërehet edhe në sferën e toponimeve (emrave të vendeve) etj. Me krijimin e mbretërisë së tyre (diku prej shek. XII e tutje), me gjasë edhe shumë më herët, Serbia nisi në mënyrë institucionale të merrej, pra, përveç tjerash, edhe me emërtimin e vendbanimeve të pushtuara nga shqiptarët. Ata donin ta "serbizonin" vendin e pushtuar. Hovin e Serbisë e ndali pushtimi turk i saj dhe i Shqipërisë (në atë kohë Kosova dhe të gjitha trojet e tjera që sot gjenden nën Serbi, Mal të Zi, Maqedoni apo Greqi quhej Arbëri, që ishte emri i vjetër për Shqipërinë e sotme). Gjatë pushtimit osman emërtimi "**Kosovo**" nuk u dëgjua më, pra mbeti vetëm në arkivat serbe. Por kur Turqia u largua nga Ballkani (më vitin 1912), Serbia, bashkë me reprezaljet e tmerrshme që bënte mbi shqiptarët, për t'i përzënë nga tokat e tyre, i nxori nga arkivat "tefteret" me toponimet serbe dhe prapë kudo që shkonte i "emërtonte" vendbanimet shqiptare me emra të vet. Më lehtë manipulonte me mikrotoponimet (vendbanimet të vogla, fshatrat etj.), të cilat, shpesh i bënte rrafsh me tokë, pastaj posa shqiptarët i ndërtonin ato, serbët "i emërtonin" si donin vetë. Fatkeqësisht, emërtimet serbe a bullgare të vendbanimeve shqiptare edhe sot "jetojnë" në Kosovë, por të tilla ka mjaft edhe në Shqipërinë e sotme. Toponime të tilla janë aq shumë sa zor që mund të përmenden të gjitha këtu. Ndërkaq vendbanimet shqiptare të vjetra (kur është fjala për qytete më të mëdha), Serbia kryesisht përpiquej t'i "modifikonte", ose t'i "serbizonte". Ajo shpesh edhe ua ndërronte emrat fare, si p. sh.: Durrësin e bëri "**Draç**", Shkodrën "**Skadar**", Tivarin "**Bar**" Ferizajin "**Uroshevac**" (pasi që Ferizaji lidhej me emrin "Feriz" serbët e ndërruan në "Uroshevac" nga emri serb "Urosh"), Pejëën "**Peq**", Shkupin "**Skopje**", Kosovën "**Kosovo**" etj. **Alpet Shqiptare** ata i quajtën "**Prokletije**", që në shqip do të thotë "**të nemuna**". Është e çuditshme se si mbeti ky emër. Me sa di unë ushtria serbe gjatë depërtimit të saj për në Shqipëri, nëpërmjet të Alpeve Shqiptare (në kohë dimri) kishte vuajtur shumë dhe një numër i madh i ushtarëve kishin vdekur nga të ftohtët gjatë këtij rrugëtimi. Dhe serbët i paskan pasë "nemun" këto male! Pra malet tona u "mallkuan" nga ata! Nuk është e çuditshme pse ata i "mallkuan", por është e çuditshme pse shqiptarët t'i quajnë edhe sot e kësaj dite kështu siç i "emërtuan" serbët "**Bjeshkë e Nemuna**", në vend se t'i quajnë shqip "**Alpet Shqiptare**" ?!

Është një bagazh emrash që sllavët ua lanë, në vazhdimësi, vendbanimeve shqiptare. Kjo ndodhi ngase, siç u përmend më lart, serbët e patën pushtetin në duar të tyre, prandaj arrinin t'i ngulitnin këto toponime madje edhe me detyrim. Emra të tillë ka sa të duash, por po i përmendim vetëm disa, si: **Obiliq** (sot quhet Kastriot, që nuk di çfarë lidhje ka kjo me Obiliqin, por ne jse) **Orloviq**, **Devet Jugoviq** (sot Bardhosh),

**Serbicë**, (sot Skënderaj), **Zubin Potok** (!) **Babin Most**( shqiptarët e "përshtatën" si "Babimovc"!), **Kisella Banja**, afër Podujevës (në "Sallabajë") e deri tek qytetet e mëdha, si: Manastiri të quhet "**Bitolla**"( bullgarisht) Kërçova, "**Kiçevo**", madje edhe qyteti i Pogradecit, buzë liqenit të Ohrit, është me origjinë sllave (lexo: bullgare) "**Pod Gradec**" etj. etj.

Të kthehemi prapë tek emërtimi (toponimi) "Kosovo".

*Në qoftë se në kohërat kur ishim nën okupim të Serbisë ishim "të detyruar" ta merrnim atë emërtim që na servohej, për arsye që tanimë dihen, çfarë mund të thuhet tani për kohën e re? A mundemi ne tash që emrat që i la Serbia në trojet tona t'i ndërrojmë me emra tanë? Ose a mundemi që ata emra, të cilët pushtuesi i "serbizoi", t'i "shqiptarizojmë", t'i bëjmë ashtu siç ishin përpara? Ose, a mundemi që për vendet ku emërtimi është i burimit sllav, t'i krijojmë toponimet shqipe?*

Natyrisht se mundemi, bile është për t'u përshëndetur iniciativa, se në vitet e fundit tek ne, vërtetë, ka filluar që kjo punë të bëhet në mënyrë institucionale. *Por kur do të arrijmë që ta heqim modelin "Kosovo" nga përdorimi në shumë institucione ndërkombëtare e vendore që po përdoret jo vetëm jashtë, por edhe në Kosovë? Kur do të hiqet nga përdorimi emërtimi nga veturat e policisë së Kosovës: KOSOVO POLICE, ose mbishkrimi nga Forcat e Sigurisë së Kosovës: KOSOVO SECURITY FORCE, të cilat UNMIK-u ose EULEX-i i "instaloj" në Kosovë? Pse të mos figurojë në veturat e policisë së Kosovës mbishkrimi shqip: POLICIA KOSOVARE( ose POLICIA E KOSOVËS), ose FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS? Pra, pse të mos shkruhen shqip?!*

Po t'i shikosh më detajisht do të vëresh se këto mbishkrime le që nuk po shkruhen shqip, por po shkruhen me një "përzjerje" të çuditshme serbisht dhe anglisht, e ku?! Në Kosovë! Këtë "njollë" e kemi "dhuratë" nga UNMIK-u, i cili, edhe pse shkoi la shumë ligje, e rregullore të tjera, në mesin e të cilave edhe këto emërtime të përditshme, që t'i vrasin sytë kur i sheh dhe veshët kur i dëgjon! Një ilustrim që shkon në favor edhe të huajt, mund t'i thonë toponimet vërtetë shqip është edhe një reklamë që shpesh po jepet në TV. Një biznesmen anglez që po i reklamon disa banesa në "Çelsi Point" (Chelsea Point) në Fushë Kosovë, edhe pse po shprehet në gjuhën angleze, ai po e përdor emërtimin shqip "**...in (në)Fushë Kosova**" (pra jo... in "Fushë Kosovo) etj.

Tani, në vendin tonë të ri, rrethanat janë krejt tjera. Sot e "kemi" situatën vetë në dorë, ose, më mirë të themi, duhet ta kemi situatën vetë në dorë. Prandaj nuk bën, as nuk ka kuptim, që edhe tash në vazhdimësi të qëndrojë emërtimi "**Kosovo**". Duhet të merret një aksion në nivel shtetëror që, të gjitha emërtimet, dokumentet zyrtare etj., të cilat e kanë këtë emër në këtë formë të korrigjohen. Pra të angazhohemi të gjithë, prej instancave më të ulëta e deri tek ato më të larta shtetërore, t'i largojmë këto trajta të dëmshme për gjuhën shqipe. Shkurt ta heqim këtë "damkë" që na e la Serbia.